



## Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

### Kumtesë e Odës së Stomatologëve të Kosovës për zbatueshmërinë e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të stomatologëve

Bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës që janë në fuqi, me të cilat rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve shëndetësorë (stomatologëve) të punësuar në sektorin publik dhe privat, Oda e Stomatologëve të Kosovës, në lidhje me kompetencat që i takojnë sipas:

1. **Ligjit për Odat e Profesionistëve** 04/L-150, neni 2, pika 1, dhe neni 10, pika 1.1, dhe
2. **Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës** neni 16, pika 1.1,

ka për obligim mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të komunitetit të stomatologëve përmes ngritjes së shqetësimeve dhe brengave të tyre në nivel institucional për çështjet që prekin fushëveprimin e stomatologut në punën e përditshme profesionale.

Duke u bazuar në këtë OSK ka ngritur shqetësimet e anëtarësisë së tyre në lidhje me moszabtimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me:

- **Ligjin e Punës** 03/L-212, neni 22, pika 1 (për shkurtimin e orarit të punës) dhe neni 32, pika 3 (për kohëzgjatjen e pushimit vjetor);
- **Kontratën Kolektive Sektoriale** me nr. 05-3815, e datës 12.06.2018 e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës neni 9, pika 1 (rrezikshmëria në vendin e punës) dhe pika 3 (orari i punës), neni 13, pika 2 (pushimi vjetor), dhe neni 16, pika 4 (pushimi mjekësor);
- **Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë** 04/L-161, neni 5, pika 3 (vlerësimi i rrezikut në vendin e punës), neni 7 (masat parandaluese), dhe neni 16 (vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës); dhe
- **Udhëzimin Administrativ** nr. 13/2011 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, neni 3, pikat 1.1, 1.3, 1.4 dhe 1.5 (punët me ndikime të dëmshme) dhe neni 4 (kohëzgjatja e pushimit vjetor).

Mos respektimi i këtyre dispozitave ligjore dhe mos plotësimi i kushteve të punës, është ndër shkaktarët kryesor i cili po ndikon në migrimin e profesionistëve shëndetësorë jashtë Republikës së Kosovës.

Oda e Stomatologëve të Kosovës kërkon nga institucionet shëndetësore, institucionet kompetente të nivellit qendror dhe atij lokal, që të trajtojnë me seriozitetin më të madh kërkesat e komunitetit të stomatologëve për plotësimin e këtyre kushtetve

Oda e Stomatologëve të Kosovës do të përdorë të gjitha mjetet institucionale për të bashkëpunuar me akterët të tjerë shtetëror deri në plotësimin e kërkesave për përmirësimin e kushteve të punës sipas legjislacionit të paraparë.

Prishtinë,

22.01.2020



*Blerim Kamberi*  
Prof.Dr. Blerim Kamberi

Kryetari i OSK-së